

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, divizion penal sipas gjyqtarit Skender Shefkiu, me asistenten Ajeshë Bekteshi, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit G. B. nga f. . K. Vitisë, për shkak të vepres penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, dhe nenit 54.1 të LSKRR-ës, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Shtetore nga Gjilani PP.II.nr.1333/2015, të datës 25.09.2015, duke vendosur lidhur me kërkesën e PSH-re, për dhënjen e urdhërit ndëshkimor me 15.09.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Shtetore nga Gjilani PP.II.nr. 1333/2015, të datës 25.09.2015, dhe Gjykata jep këtë:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I akuzuari G. B. nga babai .xx, i data e lindjes ..., në f. ..K.Viti ku edhe jeton, penzioner, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE

Me datën 02.08.2015, rreth orës 16:50 minuta, në rrugën Viti-xx, i pandehuri deri sa drejtonte automjetin e markës “Passat”, me tabela të regjistrimit 06-xxxAxx, nga pakujdesia ka shkelur Ligjin mbi Sigurimin e Komunikacionit Rrugor nga neni 54.1, përkatësisht mos përshtatja e shpejtësisë kushteve ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet dhe ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit në mënyrë që mjetin e vet ta ndal para cdo pengese që paraqitet në rrugë, me c’rast me të arritur në rrugën dytësore të rruga “xxx “, godet biciklistin tani të dëmtuarin F. S.i cili ishte duke drejtuar biciklen në drejtim të njëjtë, dhe i cili paraprakisht ka dhënë shenjë me dorë për tu kthyer në të majtë, dhe nga kjo goditje të njëjtit i shkakton lëndime trupore të përshkruar si në raportin mjekësor nga ordinanca private në Viti ORD “xxxxs”.

-Me çka ka kryer vepren penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, dhe nenit 54.1 të LSKRR-ës.

Andaj Gjykata në bazë të neneve 41, 46 e 73 të KPP-së dhe të dispozitave të cekura ligjore.

E G J Y K O N

Me denim gjobë ne shumë prej 250.00 Euro, (dyqindëpesëdhjeteuro).

Denimin e shqiptuar do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, në raste të mos pagesës të njejtat do të shëndrrohet në denim burgu efektiv prej **12 ditësh**, duke llogaritur nga **20.00 Euro (njeteteuro)**, për një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguaj Gjykatës shumë prej **10.00 Euro (dhjeteuro)** të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F. S. nga Vitia rr “xxx” për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

PSH-re nga Gjilani, me aktakuzën PP.II.nr.1333/2015, të datës 25.09.2015, e ka akuzuar **G.B.** nga f. K.Viti , për shkak të vepres penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-ës dhe nenit 54.1 të LSKRR-ës.

Njiherit ka paraqitur kërkesën për dhenjen e urdhrit ndeshkimor me arsyetim se ekzistojn provat e mjaftushme nga kallzimi penal për bazushmerinë e aktit akuzues dhe të kërkesës për dhënjen e urdhrit ndeshkimor.

Gjyqtari gjatë shiqimit të çështjes duke vepruar sipas nenit 494 të KPP-së, vleron se janë plotsuar kushtet nga neni 493 të KPP-së, dhe me aplikimin e nenit 495 e aprovoi kërkesën e PSH-re, për dhënjen e urdhrit ndeshkimor ndaj të akuzuarit.

Gjykata po ashtu konsideron dhe vleron se provat e bashkangjitura në aktin akuzues si kallzimi penal, procesverbali, dhe shkresat tjera, janë prova të besushme dhe të mjaftushme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i akuzuari ka kryer vepër penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Gjykata vleroj se të dhënat në aktin akuzues ofrojnë bazë të mjaftushme për dhënjen e urdhërit ndeshkimor, aprovoi kërkesën e PSH-re, të akuzuarin e shpall fajtor dhe i shqipton urdhërin ndeshkimor-denim me gjobë si në dispozitiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, ndersa Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike konform nenit 458 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI

P.nr.485/2015

Me.dt. 15.09.2016,

**Asistentja ,
Ajshe Bekteshi**

**Gj y q t a r i,
Skender Shefkiu**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, kundërshtimi i paraqitet kësaj Gjykate.